Kuvendi i Komunës Klinë
01Nr. 06-31240 */2026*
Datë: 28.09 */2026*

Duke u mbështetur në nenin 40, paragrafi 2, shkronjën b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenet 7 dhe 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, nenin 61 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048, Kornizën Afatmesme 2027-2029, nenin 40, paragrafi 2, nën pikën 2 të Statutit të Komunës së Klinës, debatin me publikun më 04.09.2026, si dhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 09.09.2026, Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e VIII-të të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më 25.09.2026, mori këtë:

V E N D I M

Për
miratimin e buxhetit komunal për vitin 2027, përfshirë projektet kapitale

1. Miratohet buxheti i Komunës së Klinës për vitin **2027**, duke përfshirë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe projekteve kapitale.

2. Buxheti i përgjithshëm për vitin **2027** është në shumë totale prej **16,845,517.00 Euro.**

3. Buxheti përfshin:
a) Shpenzime të rregullta funksionale të institucioneve të Komunës;
b) Shpenzime kapitale për projekte me prioritet në infrastrukturë, arsim, shëndetësi, ambient dhe shërbime publike.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është buxheti i miratuar së bashku me projektet me prioritet për vitet **2027**, **2028** dhe **2029**, të cilat janë përfshirë në buxhet.

5. Kryetari i Komunës së Klinës është përgjegjës për koordinimin dhe zbatimin e projekteve dhe respektimin e buxhetit të miratuar, së bashku me drejtoritë përgjegjëse.

6. Vendimi hyn në fuqi **30** ditë pas dërgimit te autoriteti mbikëqyrës **(MAPL),** bazuar në Ligjin **Nr. 08/L-284**, dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Klinës.

<u>Me këtë vendim njoftohen:</u>

- *MAPL;*
- *Kryetari i Komunes;*
- *Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim;*
- *Zyra për Informim;*
- *Arkivi.*

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIC OF KOSOVO · KOMUNA E KLINËS · MUNICIPALITY OF KLINA · OPŠTINA KLINA

Kryesues i Kuvendit
Enver Berisha